

32004R0104

Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 104/2004 e 22 janarit 2004 që përcakton rregullat mbi organizimin dhe përbërjen e Bordit të Apelit të Agjencisë së Sigurisë të Aviacionit Evropian

Gazeta Zyrtare L 016, 23/01/2004 fq.0020-0022

Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 104/2004 e 22 janarit 2004 që përcakton rregullat mbi organizimin dhe përbërjen e Bordit të Apelit të Agjencisë së Sigurisë të Aviacionit Evropian

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EVROPIANE

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian

Duke pasur parasysh Rregulloren (KE) Nr. 1592/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 15 korrikut 2002 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe që themelojnë Agjencinë e Sigurisë së Aviacionit Evropian, siç amendohet së fundmi nga Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 1701/2003 (2) dhe në veçanti, nenin 31pika (3) dhe nenin 32 (5) të saj,

Duke pasur parasysh që:

(1) Rregullorja (KE) nr 1592/2002 i jep kompetencën Agjencisë së Sigurisë së Aviacionit Evropian (Agjencia) për të marrë vendime individuale në fushat e aftësisë së fluturimit dhe çertifikimit mjedisor, investigimit të ndërmarrjeve, pagesës së tarifave dhe detyrimeve të zbatueshme; ajo gjithashtu krijon një Bord Apeli pranë të cilit mund të apelohe vendimet individuale të Agjencisë.

(2) Nenet 31 dhe 32 të Rregullores (KE) nr 1592/2002 autorizojnë Komisionin të miratojë rregulla të detajuara në lidhje me numrin e bordeve të apelit, ndarjen e punës, kualifikimet e kërkuara për anëtarët e secilit bord dhe kompetencat e anëtarëve individualë në fazën përgatitore të vendimeve, si dhe kushtet e votimit.

(3) Pritet që numri i apeleve të jetë mjaft i kufizuar, të paktën për sa kohë që Rregullorja (KE) nr 1592/2002 nuk është ndryshuar për të zgjeruar qëllimin e saj ndaj veprimeve të fluturimit dhe liçensimit të ekuipazhit.

(4) Bordi do të shqyrtojë çështjet për të cilat kryesisht kërkohet një përvojë teknike e përgjithshme e nivelit të lartë në fushën e çertifikimit; megjithatë, është e nevojshme që Bordi të drejtohet nga një anëtar ligjërish i kualifikuar me përvojë të njohur nga Komuniteti dhe legjislacioni ndërkombëtar. Ky anëtar duhet të jetë Kryetari.

(5) Për të lehtësuar trajtimin dhe zgjidhjen e apeleve, duhet të emërohet një referues për secilin rast, i cili, ndër të tjera, duhet të jetë përgjegjës për përgatitjen e komunikimeve me palët dhe për përpilimin e vendimeve.

(6) Për të siguruar funksionimin normal dhe eficient të Bordit të Apelit, pranë tij duhet të atashohet një zyrë regjistrimi, personeli i të cilit do të jetë përgjegjës për të gjitha funksionet mbështetëse që nuk përfshijnë asnjë liri zgjedhjeje teknike ose ligjore.

(7) Masat e parashikuara në këtë Rregullore janë në përputhje me mendimin e Komitetit, të krijuar sipas nenit 54 pika (3) të Rregullores (KE) nr 1592/2002,

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Numri i bordeve

Për qëllim të vendosjes në lidhje me apelet nga vendimet e referuara në nenin 35 të Rregullores (KE) nr 1592/2002, krijohet një Bord Apeli.

Neni 2

Kualifikimet e anëtarëve

1. Bordi i Apelit do të përbëhet nga dy anëtarë teknikisht të kualifikuar dhe një anëtar ligjërishit i kualifikuar, i cili do të jetë Kryetari i Bordit.
2. Anëtarët e kualifikuar teknikisht dhe zëvendësuesit e tyre duhet të kenë mbaruar studimet universitare ose një kualifikim të barazvlefshëm dhe duhet të kenë përvojë thelbësore profesionale në fushën e certifikimit në një ose më shumë disiplina të përcaktuara në Shtojcën e kësaj Rregulloreje.
3. Anëtari ligjërishit i kualifikuar dhe zëvendësuesi i tij duhet të jenë diplomuar për drejtësi dhe të jenë të kualifikuar, me përvojë të njohur nga Komuniteti dhe legjislacioni ndërkombëtar.

Neni 3

Kompetencat e Kryetarit

1. Bordi i Apelit do të mblidhet nga Kryetari i tij. Kryetari do të sigurojë cilësinë dhe pajtueshmërinë e vendimeve të Bordit.
2. Kryetari do t'i caktojë shqyrtimin e një apeli njërit prej anëtarëve të Bordit si referues.

Neni 4

Roli i referuesve

1. Referuesi do të kryejë një studim paraprak të apelit.
2. Referuesi do të sigurojë një konsultim të ngushtë dhe shkëmbim informacioni me palët e procedimeve. Për atë qëllim, referuesi do të:
 - (a) përgatitë komunikime për palët, duke iu nënshtruar drejtimit të Kryetarit të Bordit;
 - (b) komunikojë çdo defekt që duhet ndrequr nga një palë e procedimeve;
 - (c) përcaktojë afate kohore procedurale në përputhje me nenin 39 (2) të Rregullores (KE) nr 1592/2002; dhe

- (d) firmosë të gjitha komunikimet në emër të Bordit.
- 3. Referuesi do të përgatitë takimet e brendshme të Bordit dhe procedimet verbale.
- 4. Referuesi do të përpilojë vendimin.

Neni 5

Zyra e Regjistrimit e atashuar pranë Bordit të Apelit

- 1. Drejtori Ekzekutiv do të atashojë një zyrë regjistrimi pranë Bordit të Apelit. Personeli i zyrës së regjistrimit nuk do të marrë pjesë në ndonjë procedim të Agjencisë në lidhje me vendimet që mund të paraqiten sipas apelit.
- 2. Personeli i zyrës së regjistrimit do të jetë përgjegjës veçanërisht për:
 - (a) mbajtjen e një regjistri të sigluar me gërmën e parë nga Kryetari në të cilin të vendosen në rend kronologjik të gjitha apelet dhe dokumentat mbështetëse;
 - (b) marrjen, transmetimin dhe ruajtjen e dokumentave;
 - (c) përmbushjen e funksioneve të tjera mbështetëse në Bordin e Apelit, që nuk përfshijnë asnjë liri zgjedhjeje ligjore ose teknike, veçanërisht për sa i përket përfaqësimit, dorëzimit të përkthimeve dhe njoftimeve;
 - (d) paraqitjen pranë Kryetarit të Bordit të një raporti mbi pranueshmërinë formale të secilit apel të depozituar së fundi;
 - (e) përpilimin e procesverbaleve të procedimeve verbale kur të jetë e nevojshme.

Neni 6

Shqyrtimet

- 1. Vetëm anëtarët e Bordit do të marrin pjesë në shqyrtime; megjithatë, Kryetari i Bordit mund të autorizojë të marrin pjesë punonjës të tjerë si personeli i zyrës së regjistrimit ose interpretuesit. Shqyrtimet do të jenë të fshehta.
- 2. Gjatë shqyrtimeve midis anëtarëve të Bordit, mendimi i referuesit do të dëgjohet i pari dhe mendimi i Kryetarit do të dëgjohet i fundit.

Neni 7

Kushtet dhe rendi i votimit

- 1. Vendimet e Bordit të Apelit do të merren nga një shumicë e anëtarëve të tij. Në rast të një barazimi, vota e Kryetarit të Bordit do të jetë vendimtare.
- 2. Nëse votimi është i nevojshëm, votat do të merren në rendin e parashikuar në nenin 6 pika (2). Nuk lejohen abstenime.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e 20-të pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Kjo Rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Hartuar në Bruksel, më 22 janar 2004

Për Komisionin

Loyola De Palacio
Zëvendës-president

(1)GZ L 240, 7.9. 2002, fq 1

(2) GZ L 243, 27.9.2003, fq 5

SHTOJCË

LISTA E DISIPLINAVE

1. Disiplinat teknike të mëposhtme:

- (i) fluturimi/permanca
- (ii) struktura
- (iii) sistemet hidromekanike
- (iv) sistemet me helika/të transmisionit
- (v) ndriçimi elektrik/HIRF
- (vi) avionika/softueri
- (vii) instalimi i centralit elektrik/sistemet e lëndëve djegëse
- (viii) siguria e kabinës/sistemet mjedisore
- (ix) zhurma/emetimet
- (x) aftësia e vazhdueshme e fluturimit/rregullat e aftësisë së fluturimit, siç aplikohen për produktet e mëposhtme, pjesët dhe pajisjet e tyre:
 - (a) aeroplanët e mëdhenj
 - (b) helikopterët
 - (c) avionët e vegjël
 - (d) aerostatë/aerostatët e drejtuar/avionët pa motorë/UAV's
 - (e) motorët/APUs/helikat.

2. Miratimet dhe sistemet e cilësisë të shoqëruara me to:

- (i) organizatat e projektimit
- (ii) organizatat e prodhimit
- (iii) organizatat e mirëmbajtjes